



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITIME
Nr.01-060/01-7790/21 datë:02.04.2021



Npi – 01/103 datë: 20.04.2021

Duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) dhe 17 pika (f) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr 28/2008); Nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme Nr.03/L-139, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205 të datës 28 tetor 2010. Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi Propozim-Vendimin e Kryetarit të Komunës, Nr.02/84 datë 06.04.2021, për shpalljen me Interes Publik të Ngastrave Kadastrale Nr.372/0 dhe 373/0, pronë e Salih dhe Shaban Halili nga fshati Rancë, e bazuar në kërkesën e palës, z.Perparim Halili, Rr.”Anton Çeta” Nr.95 – Shtime, numër: Nr.02-070/05-4076/21 datë:12.02.2021, i cili në emër të Salih dhe Shaban Halilit ka kërkuar nga Kuvendi, shpronësimin e këtyre pronave:

1. Salih /Halil/ Halili nga fshati Rancë, Ngastra Kadastrale 372-0, me sipërfaqe prej 190 metra katror, vendi i quajtur “Shulani” Shfrytëzimi aktual i parcelës “Rrugë Private” në Zonën Kadastrale – Rancë, dhe.
2. Shaban /Rifat/ Halili nga fshati Rancë, Ngastra Kadastrale 373-0, me sipërfaqe prej 535 metra katror, vendi i quajtur “Shulani” Shfrytëzimi aktual i parcelës “Pemishte e klasit të 3” në Zonën Kadastrale – Rancë.

Kuvendi Komunës, pasi analizoi, Propozim-Vendimin e Kryetarit, si dhe Rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM NGASTRËN 373-0

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 20.04.2021, unanimisht aprovoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm, Ngastrën Kadastrale P-72809070-00373-0, me sipërfaqe prej 535 (pesëqind e tridhjetë e pesë) metra katror, te vendi i quajtur “Shulani” Shfrytëzimi aktual i parcelës “Pemishte e klasit të tretë” në Zonën Kadastrale – Rancë, Evidentuar pronë private e Shaban /Rifat/ Halili nga fshati Rancë.

II

A r s y e t i m: Shpallja me interes të përgjithshëm të Ngastrës Kadastrale me numër P-72809070-00373-0, me sipërfaqe prej 535 m², është bërë me qëllim të qasjes publike te objektet e Shtabit të UÇK-së, në fshatin Rancë.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj